



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATË/A:	02.05.2025
REFERENC-Ë:	642-25-2327-2-1-1
PËR/ZA/TO:	Operatori Ekonomik: “MITRO VET SH.P.K”
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Zyra e Prokurimit - Kushtrim Mehaj – Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim në Kërkesën për Rishqyrtim për Aktivitetin e Prokurimit “ <i>Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak</i> ”, me nr. të prok: 642-25-2327-2-1-1

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Mitrovicës Jugore në mbështetje të nenit 108/A, (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të Operatori Ekonomik: “MITRO VET SH.P.K”, të datës 28.04.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “*Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak*”, me nr. të prok: 642-25-2327-2-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të AK-së të publikuar me datën 16.04.2025, Autoriteti Kontraktues nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim me datë 28.04.2025, e parashtruar nga Operatori Ekonomik: “MITRO VET SH.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “*Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak*”, me nr. të prok: 642-25-2327-2-1-1, kundër NJOFTIMIT për Kontratë, dokumentet e tenderit të AK-së të publikuar me datën 16.04.2025.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: “MITRO VET SH.P.K”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “*Trajtimi i qenëve që bredhin lirshum në Komunën e Mitrovicës - qentë endacak*”, me nr. të prok: 642-25-2327-2-1-1, kundër NJOFTIMIT për Kontratë, dokumentet e tenderit të AK-së të publikuar me datën 28.04.2025, ka bërë Kërkesës për Rishqyrtim me datë 28.04.2025 sipas nenit 108/A, të Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L/237.

- **PRETENDIMI ANKIMOR 1) NGA OE "MITRO VET SH.P.K":**

Kërkesa për Rishqyrtim nga 28.04.2025 OE "MITRO VET SH.P.K":

Pretendimi 1 .

Tek kërkesat mbi Kapacitetin ekonomik dhe financiar :

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar në vlerë të përgjithshme prej min 300,000.00 €, per tri vitet e fundit financiare. Në rast të konzorciumit - Lideri 60%.

Konsiderojmë se një kërkesë e tillë për qarkullim në vlerë kaq të lartë prej 300,000€, çënon konkurrencen e lirë, dhe pamundëson qe operatorët ekonomik te kualifikuar që ofrojnë shërbime veterinarë te përjashtohen nga ky aktivitet i prokurimit, duke pasur parasysh natyrën specifike të këtij shërbimi dhe strukturën e tregut lokal kur dihet se nuk ka pasur tender te vlerave kaq te medha ne Mitrovice,perveq atij te vitit te kaluar te cilen e ka marrur nje OE e ne te cilin pikërisht ju si Autoritet Kontraktues kur keni publikuar tenderin për trajtimin e qenve endacak në vlerën prej 320,000 eurove , nr.prok 642-23-4549-2-1-1 , fare nuk keni pasur nje kerkese te tille, dhe duket qarte se kerkesa i eshte pershtatur operatorit qe ka qene i rekomanduar per kete tender , njesoj sikurse edhe kerkesat e tjera .

Numri i Prokurimit: 642-23-4549/2020-2-1-1 Titulli i kontratës: mbanja, mbanja dhe trajtimi i Qenve Endacak qe breshthi bashem ne Qytetin e Mitrovice dhe Periferi.

		TVSH-së 3. Licencën për ushtrimin e veprimtarisë nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit - AVUK	(kopje) 3. Kopje të Licencës për ushtrimin e veprimtarisë nga Agjencioni i Veterinës dhe Ushqimit - AVUK
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	0.1 & 0.2	Ekonomikë i finansijski kapacitet N A	Dëshmia e kërkuar dokumente N A

Ne krahasim me Dosjet e Tenderit te publikuara edhe nga Autoritetet tjera Kontraktuese,sic eshte Komuna e Prishtines, nuk kemi hasur ne nje kerkese te tille, andaj kerkojme qe vlera e qarkullimit financiar te zbritet ne perputhje me natyren e shërbimeve dhe tregun lokal,ne ate menyre qe nuk diskriminon apo favorizon asnje OE te interesuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 1 ANKIMORE NDAJ OE "MITRO VET SH.P.K":

Në lidhje me pretendimin tuaj për kriterin që ka të bëjë me kërkesën për qarkullim financiar minimal prej 300,000.00 € për tri vitet e fundit, ju njoftojmë si vijon:

Kriteri është i ligjshëm dhe i arsyetuar në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës. Kërkesa për një nivel të caktuar të qarkullimit financiar është një praktikë standarde në procedurat e prokurimit publik dhe ka për qëllim të sigurojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin e nevojshëm financiar për të përmbushur me sukses kontratën në fjalë. Duke marrë parasysh **shtrirjen territoriale, natyrën komplekse logjistike, dhe përgjegjësitë shumëdimensionale** që lidhen me trajtimin e qenve endacak, është e domosdoshme që operatori të dëshmojë një stabilitet financiar të mjaftueshëm.

Krahasimi me tenderin e kaluar nuk qëndron.

Tenderët janë të pavarur nga njëri-tjetri dhe kriteret përcaktohen rast pas rasti, duke marrë parasysh përvojat e mëparshme dhe nevojat aktuale të kontraktuesit. Mungesa e një kriteri të caktuar në një tender të kaluar nuk e përjashton të drejtën e Autoritetit Kontraktues për ta përfshirë atë në procedura të ardhshme, sidomos nëse konsiderohet e nevojshme për cilësinë dhe sigurinë e zbatimit të kontratës.

Kriteri nuk është diskriminues dhe nuk favorizon asnjë operator. Kërkesa për qarkullim financiar nuk kufizon konkurrencën në mënyrë të pajustificueshme dhe aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët. Për më tepër, është lejuar pjesëmarrja e konsorciumeve, ku lideri mund të mbulojë 60% të shumës së kërkuar – duke krijuar fleksibilitet dhe duke mundësuar pjesëmarrjen më të gjerë të tregut.

Andaj Pretendimi 1 refuzohet dhe është i pabazuar.

• PRETENDIMI ANKIMOR 2) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi 2

Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale :

Kërkesa 1. Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të përfunduara me vlerë 300,000.00 për shërbime të ngjashme në 3 (tri) vitet e shkuara “ose “në periudhën e shkuar trevjeçare), e cila ndërlidhet me periudhën që paraprinë datës e publikimit të njoftimit për kontratë. Në rast të konzorciumit - Lideri 60%

Duke qenë se në rajonin e Mitrovicës, për shërbime që lidhen me trajtimin e qenve endacak, nuk ka pasur tenderë me vlera të tilla, përveç një tenderi specifik të vitit të kaluar që është rekomanduar një operatore ekonomik në po këto vlera që po kërkohej, një kërkesë e tillë dukshëm përjashton operatorët e tjerë, të cilët mbase nuk e arrijnë këtë vlerë.

Këtë e konsiderojmë krejtësishtë kërkesë diskriminuese/favorizuese marre parasysh që në tenderin e vitit të kaluar me vlera të parashikuar buxhetore prej 320,000 euro me nr.prok 642-23- 4549-2-1-1 as që është kërkuar fare lista e kontratave të realizuara dhe as qarkullimi vjetor , andaj ky është standard i dyfishtë i Autoritetit Kontraktues, dhe kërkojmë që të largohet.

Numri i Prokurimit: 642-23-4549/100-2-1-1 - Titulli i Marrëdhënies: shërbime të trajtimit të qenve Endacak që brendshin tërësisht në Qytetin e Mitrovicës dhe Prokurimi i Qenve Endacak që brendshin tërësisht në Qytetin e Mitrovicës dhe Prokurimi

		TVSH-ë 3. Licencën për shërbime të veterinarisë nga Agjencioni i Veterinës dhe Udhëheqësi - AVUE	Shërbime 3. Kërkje të Licencës për shërbime të veterinarisë nga Agjencioni i Veterinës dhe Udhëheqësi - AVUE
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe finansiare	81.5.2	Ekzistenca e fuqisë së kapacitetit 81.5	Dëshmia e kërkuar dokumentare 81.5
Kërkesat mbi mundësitë teknike	91.5.2	Pasqyra e profesionalizimit Kërkesa 1. Të tilla që përbëjnë dy (2) veterinarë të diplomuar që tani që përbëjnë dy vjet përvojë pune në terren, tani (4) tani të veterinarëve dhe gjatë (6) punës për shërbime - të diplomuar me kontratë sipas Udhëheqësit Administrativ. Kërkesa 2. Licencën nga vendimi për shërbimet ose qendrën për kafshët endacakë e Miruar nga Agjencia e Udhëheqësit dhe Veterinarët. Kërkesa 3. Shërbimet që qendra duhet të jetë kapaciteti minimal për 100 qenë dhe funksionin e shërbimit ose qendrës duhet të jetë në	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Dëshmia 1. Kërkje të kontratave të realizuara me veterinarët dhe teknikët e veterinarëve si dhe dëshmitë e ATE-së për kontratën e qenve të punës për vitin 2022, tani për punën e shërbimit ose kontratën e punës Dëshmia 2. Kërkje të Licencës nga - e Vendimit për Shërbime të shërbimit ose qendrës për kafshët endacakë të Miruar nga ALP. Pasqyra 3. e shërbimit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 2 ANKIMORE NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K”:

Kriteri është i bazuar në nevojat reale të kontratës dhe në legjislacionin e prokurimit publik. Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar këtë kriter për të siguruar që operatori ekonomik ka përvojën dhe kapacitetin e nevojshëm për të kryer një kontratë me këtë nivel kompleksiteti dhe përgjegjësie. Përcaktimi i përvojës së mëparshme është një mjet legjitim për të vlerësuar aftësinë teknike dhe profesionale të ofertuesve, siç parashihet në nenet përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik. Kriteri është proporcional dhe i arsyetuar. Vlera prej 300,000 € nuk është kërkuar për një kontratë të vetme, por si vlerë e përgjithshme kumulative për kontrata të ngjashme të përfunduara në periudhën trevjeçare, çka ofron fleksibilitet dhe përfshirje të operatorëve me përvojë të qëndrueshme, edhe në kontrata të shumta me vlera më të vogla. Në rastin e një konzorciumi, është paraparë që lideri të ketë vetëm 60% të kësaj përvoje, duke e bërë kriterin edhe më gjithëpërfshirës. Mungesa e këtij kriteri në tenderin e kaluar nuk kufizon vendosjen e tij tani.

Tenderët e mëparshëm nuk janë precedent për kriteret që mund të vendosen në procedura të reja. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të rivlerësojë nevojat dhe rreziqet operative për çdo kontratë të re dhe të përcaktojë kriteret që garantojnë zbatim të suksesshëm dhe me cilësi të lartë të kontratës. Kjo kërkesë aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk ka për qëllim përjashtimin apo favorizimin e askujt. Ajo ka për synim të sigurojë se vetëm operatorët që kanë kapacitet real dhe të provuar për të ofruar shërbimin, mund të marrin pjesë në mënyrë të përgjegjshme në procedurën e prokurimit

Andaj Pretendimi 2 refuzohet dhe është i pabazuar.

• PRETENDIMI ANKIMOR 3) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi 3 :

Për stafin e angazhuar në piken 2 dhe 3 të DT thuhet “te prezantohen kontrata të noterizuara apo në prani të avokatit ” , kur sipas RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK . Autoritetet Kontraktuese përveq marrëveshjeve të nënshkruara mes paleve , nuk kanë të drejtë të parashitrojnë kërkesa të ngjashme për noterizime,apo prani të avokatit .

Sipas Nenit 26.16 thuhet se :

“Autoriteti Kontraktues në rast të dyshimit të cilitdo informacion të dorëzuar nga Operatori Ekonomik, do të kryej një kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit tek autoriteti / personi fizik përkatës dhe rrjedhimisht kërkesa e Autoritetit Kontraktues për noterizim të dokumenteve konsiderohet e panevojshme. ”

Andaj kërkojmë të largohet edhe kjo kërkesë e panevojshme e DT.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 3 ANKIMORE NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pas vlerësimit të këtij kriteri Autoriteti Kontraktues ka vendosur që të aprovoj këtë pretendim pasi që këto dokumente mund të verifikojmë në rast të ndonjë dyshimi nga ana e jonë.

Andaj Pretendimi 3 është i bazuar.

• PRETENDIMI ANKIMOR 4) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi 4

4.Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale , pika 3 është kërkuar :

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka të angazhuar Katër (4) punonjës që përkujdesen për kafshët në strehimore të cilët duhet të jenë të trajnuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.02 2023

- Për Kushtet dhe Kërkesat Teknike që duhet Plotësuar nga Strehimoret e Kafshëve Shoqëruese.

Marrë në krahasim Dosjen e kaluar te tenderit nga ju si Autoriteti Kontraktues nr.prok 642-23- 4549-2-1-1 , si dhe Dosjet e tenderit nga pothuajse të gjitha Autoritetet Kontraktuese nga asnjë nuk kërkohej nje kërkesë e tillë, pasi që në vend të kësaj kërkesë kërkohej Teknik Veterinar që kanë kryer shkollim dhe kanë përvojë adekuate në trajtimin e qenve endacak , që është shumë herë kualifikim më i lartë dhe adekuat sesa puntorë që kanë një “trajnim” dhe që i posedon një x operatorë i caktuar.

Ku mund të kontaktoni edhe me Oden e Veterinerve dhe Agjensionin e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës pasi që nuk ka kërkesa për puntorë të tillë sic janë kërkuar, por vetëm me Teknik Veterinar që janë të shkolluar dhe ka aftësitë profesionale.

Kërkojmë që edhe kjo kërkesë të largohet dhe zëvendësohet me teknik veterinar në përputhje me nevojat e projektit.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 4 ANKIMORE NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi i paraqitur lidhur me kërkesën për angazhimin e katër (4) punonjësve të trajnuar për përkujdesje ndaj kafshëve në strehimore është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023 i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i cili përcakton kushtet teknike që duhet të plotësojnë strehimoret për kafshë shoqëruese. Sipas nenit 10 të këtij Udhëzimi, respektivisht paragrafi 1 përcakton se “Çdo strehimore duhet të ketë së paku një punonjës që përkujdeset deri në 25 kafshë shoqëruese, të cilët duhet të jenë të trajnuar, në përputhje me nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrativ, që e dëshmon me certifikatë përkatëse për këtë veprimtari.”

Neni 10

Personeli i strehimores

1. Çdo strehimore duhet të ketë së paku një punonjës që përkujdeset deri në 25 kafshë shoqëruese, të cilët duhet të jenë të trajnuar, në përputhje me nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrativ, që e dëshmon me certifikatë përkatëse për këtë veprimtari.

Pra kjo kërkesë është kërkesë ligjore, si dhe është e bazuar në përvojën praktike të menaxhimit të një strehimore funksionale dhe në nevojën për siguri, dhe përmbushje të standardeve të BE-së për mirëqenien e kafshëve.

Nëse ju si OE keni personel të trajnuar – certifikuar si (punonjës teknik, teknik veterinar apo mund të quhet edhe vetëm punonjë-punëtor) sipas Nenit 11 të këtij Udhëzimi Administrativ atëherë ju mund të aplikoni në këtë aktivitet sepse potencialisht plotësohet kriteri minimal i vendosur në DT dhe NJK.

Si rrjedhojë, kërkesa e juaj për të hequr këtë kriter bic ndesh me kërkesat minimale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023 dhe nuk garanton standardin e nevojshëm për funksionimin e strehimores.

Neni 11

Trajnimi i personelit

1. Trajnimin e personelit të përcaktuar në nenin 10, paragrafin 1 i këtij Udhëzimi Administrativ e kryen personi juridik ose fizik i autorizuar nga AUV.

11. Personeli i kualifikuar nga paragrafin 1 i këtij neni konsiderohet personel që ka arsimim në mjekësi veterinarë, blegtori ose të ngjashme, si dhe personeli i cili ka përvojë po aq të vlefshme të punës njëvjeçare (1) në fushën e mirëqenies së kafshëve ose strehimore.

Ndërsa krahasimi me tenderët e mëparshëm të autoriteteve të tjera është jo-relevant, pasi çdo kontratë dhe projekt trajtohet sipas nevojave specifike të komunës dhe rrethanave aktuale.

• PRETENDIMI ANKIMOR 5) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi 5

5. Tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, pika 5, Operatori Ekonomik duhet të ketë leje të lëshuar nga MBPZHR për përdorimin e preparateve dhe kryerjen e shërbimeve për DDD.

Kjo kërkesë është e irrelevante për natyrën e shërbimit të tenderuar, i cili lidhet me trajtim mjekësor të qenve endacak, dhe nuk ka lidhje me shërbime të dezinfektimit apo deratizimit të objekteve.

Marrë në konsideratë që as në paramasë dhe parallogari nuk parashihet realizimi i ndonjë pozicioni të tillë.

Konsiderojmë se një kërkesë e tillë ndikon negativisht në konkurrencën e lejueshme, pasi vetëm operatorët që ofrojnë shërbime DDD mund të plotësojnë këtë kriter që sku fare relevance me shërbimet që do të realizohen, duke përjashtuar operatorë të tjerë të licencuar si mjekë veterinarë, andaj kërkojmë që kjo kërkesë të largohet në tërësi, pasi që në krahasim me Dosjen e tenderit të vitit të kaluar nga KK Mitrovicë, por edhe Autoritetet tjera Kontraktuese nuk kemi hasur në një kërkesë të tillë në DT, ku nga këto rrethana dëshmohet qartë se kjo Dosje Tenderi nuk është hartuar në përputhje me qëllimet dhe parimet e sanksionuara me Ligjin e Prokurimit Publik të Kosovës.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 5 ANKIMORE NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pas shqyrtimit të pretendimit tuaj dhe analizës së mëtejme të dokumentacionit të tenderit, konstatohet se kërkesa për lejen e lëshuar nga MBPZHR për ofrimin e shërbimeve DDD (dezinfektim, dezinfektim dhe deratizim) nuk është në përputhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës – trajtimin mjekësor të qenve endacak.

Duke marrë parasysh natyrën specifike të shërbimeve të kërkuara dhe për të siguruar pjesëmarrje sa më të gjerë të operatorëve relevantë, kemi vendosur që kjo kërkesë të **hiqet nga dokumentacioni i tenderit**.

Ky ndryshim bëhet në përputhje me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, veçanërisht ato që garantojnë trajtim të barabartë dhe konkurrencë të hapur mes operatorëve ekonomikë **Andaj Pretendimi 5 është i bazuar.**

• **PRETENDIMI ANKIMOR 6) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:**

Pretendimi 6

Ne Paramasen dhe Paralogarinë e projektit, shohim se në pozicionin nr 8 është parapare :

“Largimi i qenëve endacak të ngordhur që gjenden në territorin e Komunës së Mitrovicës Jugore”

Ky shërbim kryhet nga projektet e mirëmbajtjeve të rrugëve lokale dhe nacionale ,dhe nuk është fare obligim i veterinerëve të largojnë qenë të ngordhur në Mitrovicë, andaj edhe përpilimi i pozicioneve në paramasë dhe paralogari nuk është i duhur, dhe kërkojmë të largohet si pozicion.

Prove se si parashihet largimi i kafshëve të ngordhura nga rruga në paramasat e mirëmbajtjeve nacionale, të cilat kontrahetohen në vazhdimësi.

Mitrovica I	R105	R105/02	R		21.3
Mitrovica I	R105	R105/03	R		17.9
Mitrovica I	R129	R129/01	R		17.5
Mitrovica I	R120	R120/03	R		3.7
Mitrovica I	R120	R120/04	R		9.6
Mitrovica I	R804	R804/01	R		19.6
Mitrovica JK	NK	NK/14a	NK		0.7
Totali, [km]					102.2

PARAMASA DHE PARALOGARIA					
MIRËMBAJTJES VETORIE DHE DIMFRORE E RRUGËVE NACIONALË DHE RAJONALE 2022/2023					
Paralogaria 1		Punët përgatitëse dhe inspektuese		Punët në shkallën Qarkulluese	
Pika	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi njësor (€)	Vlera (€)
1.1	Inspektimet ditore të rregullta të rrugëve nacionale dhe rajonale dhe kryeve me të gjitha objektet perçelëse duke përfshirë edhe pastrimin e shiritave qarkullues nga mbeturinat e ndryshme dhe largimi i kafshëve (në baza ditore)	Miqe	1.00		

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 6 ANKIMORE NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K”:

Pretendimi i paraqitur nga ana e juaj, sipas të cilit pozicioni “Largimi i qenëve endacak të ngordhur që gjenden në territorin e Komunës së Mitrovicës Jugore” duhet të largohet nga paramasa dhe paralogaria, vlerësohet si i pabazuar.

Në praktikë, edhe nga përvoja e viteve të kaluara, është dëshmuar se asnjë operator i kontraktuar për mirëmbajtje rrugësh nuk ka kryer largimin e kafshëve të ngordhura nga rrugët lokale, paralogjet, lagjet

urbane, rrugët rurale apo fshatrat. Përkundrazi, ky shërbim është trajtuar gjithmonë si pjesë përbërëse e menaxhimit veterinar dhe të mirëqenies së kafshëve endacake në territorin e komunës.

Largimi i kafshëve të ngordhura nga hapësirat publike është thelbësor për shëndetin publik, pasi trupat e kafshëve të ngordhura përbëjnë rrezik për ndotje të ambientit, si dhe mund të jenë burim i përhapjes së sëmundjeve zoonotike (të transmetueshme nga kafsha te njeriu). Për më tepër, mospërfshirja e këtij pozicioni do të linte zbrazëtirë në përgjegjësinë institucionale për këtë aspekt, duke krijuar jo vetëm konfuzion funksional, por edhe rrezik real për komunitetin dhe ambientin. Prandaj, konsiderojmë se pozicioni nr. 8 është i justifikuar dhe do të mbetet pjesë përbërëse e kontratës dhe parashikimeve buxhetore.

Andaj Pretendimi 6 refuzohet dhe është i pabazuar

- **PRETENDIMI ANKIMOR 7) NGA OE “MITRO VET SH.P.K”:**

Pretendimi 7

Konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me Neni 46 për Rregullat e posaçme për mundësimin e shkurtimeve të afateve kohore në të cilën dispozitë përcaktohet se ky shkurtime i afateve kohore për dorezimin e tenderëve bëhet vetëm në raste urgjente të përcaktuara me dispozita ligjore.

Shkurtime i afateve pa arsye të bindëse dhe të bazuara ligjore, mund të kufizojë konkurrencën dhe për rrjedhojë mosmarrjen e ofertave më të përgjegjshme.

Kërkojmë që ndryshimet e kërkuara të behen konform LPP-se, duke respektuar formën dhe menyrat e përcaktuara, si dhe afatet kohore lidhur me ndryshimet e publikuara

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN 7 ANKIMOR NDAJ OE “MITRO VET SH.P.K

Pretendimi i paraqitur për shkurtime të afatit kohor të procedurës së prokurimit vlerësohet si i pabazuar, për shkak se veprimet e ndërmara nga Autoriteti Kontraktues janë plotësisht në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe rregullat përkatëse në fuqi.

Komuna e Mitrovicës Jugore që nga tetori i vitit 2024 nuk ka pasur kontratë aktive për trajtimin e qenve endacakë. Kjo ka krijuar një situatë tejet alarmante dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë publike të qytetarëve, për shkak të rritjes së dukshme të numrit të qenve endacakë në të gjitha lagjet dhe fshatrat e komunës.

Kjo situatë është e dokumentuar përmes ankesave të shumta të qytetarëve, të cilat janë adresuar në mënyrë zyrtare në komunë dhe në stacionet policore. Ankesat kanë të bëjnë me:

- Sulme fizike ndaj qytetarëve nga qentë endacakë, përfshirë fëmijë dhe të moshuar;
- Rrezik të përhapjes së sëmundjeve zoonotike për shkak të mungesës së kontrollit veterinar;
- Pengim të lirë të qarkullimit dhe ndotje të hapësirave publike.

Në këto rrethana, Autoriteti Kontraktues ka ndërmarrë masa të shpejta dhe të domosdoshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes, duke aplikuar shkurtime të afatit kohor brenda kufijve të paraparë me Rregullat për Prokurimin Publik në raste të nevojës së lartë urgjente, gjithnjë duke respektuar minimumin e ditëve të lejuara për konkurrencë dhe transparencë.

Prandaj, pretendimi i Operatorit Ekonomik se është vepruar në kundërshtim me nenin 46, nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse shkurtimi i afatit nuk është bërë në mënyrë arbitrare, por për shkak të rrethanave emergjente dhe me qëllim të mbrojtjes së interesit publik dhe shëndetit qytetar.

Andaj Pretendimi 7 refuzohet dhe është i pabazuar

Andaj, Autoriteti Kontraktues ju njofton se do të korrigjoj Dosjen e Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë për pretendimet e aprovuara si të bazuara ndërsa pjesët tjera mbesin ashtu siç kanë qenë.

Bazuar në të dhënat e lartëcekura Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr.04/L042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-092.